



Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ARMELIN QAZIM KONI KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË SHIJAK, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA ALEANCA PROGRESISTE LZHK”

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Armelin Qazim Koni, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, më datë 30.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik DR-LZHK 11135. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Armelin Qazim Koni, rezulton i rehabilituar.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Armelin Qazim Koni, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Armelin Qazim Koni.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Armelin Qazim Koni, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjenealitetet e tij;
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO, duke deklaruar:
“Dënuar nga Gjykata e Triestes me vendimin Nr.543/22 me 2 vite burg për shpërndarje lëndësh narkotike, vepër penale e parashikuar në nenin 854 të legjislacionit italian”
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar:
“Organi procedues Prokuroria e Triestes në Itali për shpërndarje lëndësh narkotike. Periudha 2016-2020. Rezultati burgim”.
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur”Po” duke deklaruar:
“Organi procedues Prokuroria e Triestes në Itali për shpërndarje lëndësh narkotike. Periudha 2016-2020. Rezultati burgim”.
- Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “JO” por në formular ka deklaruar:
“Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore (Revokuar). Arresti në shtëpi (Revokuar). Arresti në burg (Revokuar). Gjykata e Triestes, vepra penale shpërndarje narkotikësh (neni 854), periudha 2016-2020. Vendimi përfundimtar burgim”.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar:
“Trieste/Itali punësim nga 2003-vazhdim”.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4081 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 620/28 prot.extra 23, datë 17.05.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Armelin Qazim Koni. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Armelin Qazim Koni, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton që nuk ka patur gjeneralitete të tjera veç atyre të deklaruara në formular;
- Rezulton të jetë dënuar me vendimin e datës 28.10.2010, nga Gjyqtari i Seancës Paraprake, me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Triestës i parevokueshëm më 21/11/2012. Ankimi u shpall i papranueshëm nga Gjykata e Kasacionit të Romës më 21/11/2012, për veprat penale të mëposhtme:
 - Krimi i parë Shitja e paligjshme e substancave narkotike në përputhje me nenin 110 Kodi Penal, neni 73 DPR9/10/1990 nr.309 (kryer në nëntor 2009 në Trieste)
 - Krimi i dytë Mbajtja pa leje dhe shitja e lëndëve narkotike ka vazhduar në lidhje me nenin 81, 110 të Kodit Penal, neni 73 i DPR 9/10/1990 nr.309 (kryer nga dhjetori 2008 deri më 12/1/2009 në Trieste)
 - Krimi i tretë Posedimi i paligjshëm i substancave narkotike vazhdoi në lidhje me nenin 81,110 të Kodit Penal, neni 73 DPR 9/10/1990 nr. 309 (kryer më 4/1/2009 dhe më 5/1/2009 në Trieste)
 - Krimi i katërt Mbajtja pa leje e lëndëve narkotike vazhdoi në lidhje me nenin 81, 110, të Kodit Penal, neni 73 i DPR 9/10/1990 nr.309 (kryer më 11/1/2009 në Trieste)
 - Krimi i pestë Mbajtja dhe shitja e paligjshme e lëndëve narkotike vazhdoi në lidhje me nenin 81,110 të Kodit Penal, neni 73 i DPR 9/10/1990 nr.309 (kryer nga dhjetori 2008 deri në qershor 2009 në Trieste)
 - Krimi i gjashtë Mbajtja dhe shitja e paligjshme e lëndëve narkotike në përputhje me nenin 110 të Kodit Penal neni 73 DPR 9/10/1990 nr. 309 (kryer më 30/06/2009 në Trieste) dispozitivi lehtësues gjenerik neni 62 bis i Kodit Penal konsiderohet vazhdimësi e krimeve të përmendura në pikat1),2),3),4,)5),6) burgim për 3 vjet e 8 muaj, gjobë 16,000.00 euro dhe ndalimi i zbritjeve rituale të gjykimit të shkurtuar të dënimeve plotësuese.
 - Ndalim i përhershëm nga funksionet publike;
 - Përrjashtimi ligjor për kohëzgjatjen e dënimit;
 - Masa e sigurisë (Konfiskimi dhe asgjësimi i sendeve të sekuestruara)
 - Masat e mëvonshme të nxjerra gjatë ekzekutimit të masës 07/12/2012 me dekret të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Triestes, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit (neni 656 paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale- L.165/98) pezullim dënimi me burg 7 muaj 4 ditë. Më 30.04.2013 urdhër nga magjistrati mbikëqyrës i Triestes , urdhërohet ulje e dënimit për lirim të parakohshëm (neni 54L 354/75) dënimi u reduktua me 270 ditë.

- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjygjësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çëshje penale të pazgjidhur me vendim gjygjësor të formës së prerë.
- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Triestes Itali në kuadër të proçedimit penal nr.3026/08.
- Rezulton të ketë qënë i arrestuar në flagrancë më datë 30 Qershor 2009, datë në të cilën Koni u kap në flagrancë për kryerjen e një krimi dhe arrestuar gjatë një hetimi penal p.p 2512/DDA709 RGNR tashmë p.p 3026/08, nga Skuadra e Lëvizshme e Komisarariatit të Policisë së Triestes, për shkelje të nenit 73 paragrafi i Dekretit të Presidentit 309.1990, për tregtimin e substancave narkotike.
- Rezulton që ndaj tij në kuadër të proçedimit penal 3026/08 të jetë caktuar si masë e sigurimit personal “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi”.
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk rezulton të jetë marrë masa e dëbimit nga një shtet i huaj për çështje penale.

II.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Armelin Qazim Koni, kandidat i listës shumëmemërore të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK” për Këshillin Bashkisë Shijak Qarku Durrës, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk ka marrë asnjë mandat në këshill. Subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në bashkinë Shijak. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumëmemërore të “Partisë Aleanca Progresiste LZHK”, nuk do të mund të përfitojë mandat në këshillin e Bashkisë Shijak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfitur mandat në këshill, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

Jona JOSIFI - Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve